



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**  
**Ministria e Punëve të Brendshme**  
**Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs**

Nr. 731 /2020  
Datë: 06 / 07 /2020

Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Koordinator i Grupit Ndër-institucional për Menaxhimin e Incidenteve,

Duke marrë parasysh Nenit 10.2 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 07, 01, mars 2019), Ligjin Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse (Gazeta Zyrtare, Nr. 4, 15, Tetor 2008), Ligjin Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (Gazeta Zyrtare, Nr. 22/ 19 Tetor 2011), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafin 1.4) të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (shtojca 6) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) nr. 07/2020, Vendimin Nr.01/11 të datës 15.03.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe Vendimit Nr. 683/2020 i datës 08.06.2020 për themelimin e Ndër-institucional për Menaxhimin e Incidenteve, nxjerr:

**V E N D I M**  
**për**

**shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të leje dhe licensave**

1. Pezullohen të gjitha shërbimet me palë në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migrim si dhe shtyhet afati ligjor për parashtrimin e kërkesave dhe pezullohet afati ligjor për vendosje në shkallë të parë për çështjet, si në vijim:

- 1.1. fitim, rifitim, njohje të statusit të personit pa shtetësi dhe humbje të shtetësisë me lirim;
- 1.2. lejeqëndrim të përkohshëm, të përhershëm, viza C dhe viza D për te huajt;
- 1.3. intervistat me aplikues dhe vendimet që nderlidhen me mbrojtje nderkombetare;
- 1.4. përfitim nga skemat për riintegrimin e personave të riatdhesuar.

2. Shtyhet afati ligjor për parashtrimin e ankesave dhe pezullohet afati ligjor për vendosje në shkallë të dytë për çështjet, si në vijim:

- 2.1. ankesat për fitim, rifitim, njohje të statusit të personit pa shtetësi dhe humbje të shtetësisë me lirim;

- 2.2. ankesat kundër vendimeve të Zyrave të Gjendjes Civile;  
2.3. ankesat kundër vendimeve për skemat e riintegrit.

3. Të gjithë poseduesit e armëve të cilëve iu ka skaduar leja përkatëse, e lëshuar në pajtim me nenin 17 dhe 24 të Ligjit Nr. 05/L -022 për Armë, iu vazhdohet leja. Vazhdimi i afatit përfshinë të gjitha llojet e lejeve për armë.

4. Të gjitha kompanive private të sigurimit për ofrimin e shërbimeve private të sigurisë të cilave iu ka skaduar afati për vazhdim të licencës sipas nenit 10, 14 dhe 35 të Ligjit nr. 04/L-004 për Shërbimet Private të Sigurisë, iu vazhdohet afati i licencës përkatëse. Vendimi vlenë edhe për punëtorët e sigurimit të cilëve ju ka skaduar afati i licencës dhe kartelës zyrtare të identifikimit.

5. Ky vendim për shtyrje dhe pezullim të afateve në procedurë administrative dhe vazhdim të lejeve dhe licensave vlen deri në një vendim tjetër të Ministrit të Punëve të Brendshme.

6. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimi nr. 136/2020 i datës 24.03.2020 dhe vendimi nr.159/2020 i datës 30.03.2020.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Koordinator i Grupit Ndër-institucional për Menaxhimin e Incidenteve

#### **Vendimi t`i dërgohet:**

- Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së;
- Të gjithë anëtarëve të GNMI-së;
- Departamentit Ligjor të MPB-së;
- Arkivit të MPB-së.